



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:009400

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06452971

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-23-0729-A0001**

*Paditësi*

**Z Z** fshati P, Viti.

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

**N.SH. N.B.I. “Agromorava”,** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6778, të datës 14 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6778, i datës 14 nëntor 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 29 tetor 2014, paditësi kishte parashtruar një ankesë për rishikim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014, me të cilin vendim

kërkesa e paditësit për 3 paga të papaguara në shumën prej 600.00 euro nga N.SH N.B.I “Agromorava” ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar rezulton se kërkesa e paditësit ishte parashkruar. Gjithashtu ankesën e kishte parashtruar edhe kundër vendimit të AL-së me nr. GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 400.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se sipas vlerësimit të AL-së kjo kërkesë ishte parashkruar.

Në ankesë paditësi kishte theksuar se vendimi për refuzimin e kërkesës së tij nuk ka asnjë bazë ligjore sepse në vet njoftimin e AKP-së është thënë se kërkesat do të shqyrtohen dhe realizohen, ashtu që punëtorët do të aplikojnë pasi që të filloj procedura e likuidimit dhe jo siç thuhet në vendimin e këtij Komisioni se është dashur të iniciohet procedurë gjyqësore. I njëjti kishte kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa e tij, ashtu që e paditura të obligohet t’i paguaj paditësit shumën prej 400.00 euro për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për borxhin për 3 paga të papaguara shumën prej 600.00 euro. . Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014 dhe me nr. GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014, njoftimin për likuidimin e ndërmarrjes, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 25 nëntor 2005, listën përfundimtare të përfituesve të 20%, një konfirmim të Policisë së Kosovës, një Procesverbal të datës 15 prill 2011 si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 20 tetor 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtje në ankesën e paditësit në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, konsideron se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur nga ana e paditësit në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Pra më së voni 3 vite nga qershori 2008. AL nuk ka ndonjë provë që parashtruesi ka dorëzuar ndonjë kërkesë për kompensim në gjykatë apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda afatit 3 vjeçar si më lartë. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014 dhe me nr. GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014.

Me datë 3 nëntor 2023, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të paditurës në të cilën i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazuar mbrojtjen e të paditurës dhe të aprovoj ankesën e paditësit, ashtu që të detyroj të paditurën t'i paguaj paditësit borxhin në shumën prej 400.00 euro dhe shpenzimet gjyqësore bashkë me interesin ligjor.

Me datë 14 nëntor 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6778 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesën e paditësit, duke vërtetuar kështu vendimin e AL-së me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e ankuesit për kompensimin e 3 pagave të papaguara. Ndërsa kishte shfuqizuar vendimin e AL-së me nr. GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e ankuesit për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, duke detyruar AL-në që ankuesit në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj shumën prej 400.00 euro dhe në emër të interesit ligjor shumën prej 32.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se në rastin konkret ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara si dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë e llogaritjes së pagave të kërkuara. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të dorëzoj prova relevante dhe në mungesë të dëshmive pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Sa i përket kërkesës tjetër të paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës gjykata kishte gjetur se ankuesi ishte punëtor i N.SH-së deri në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i kishte pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP-së. Njoftimi dhe lista e punëtorëve e publikuar nga AKP-ja argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i N.SH-së deri në ditën e privatizimit të saj, respektivisht se ankuesi ishte punëtor i regjistruar me të drejtë legjitime pranë N.SH-së me rastin e përfitimit të një pjese të së hyrave nga 20% nga privatizimi i N.SH-së. AKP-ja asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do t'i mohohej e drejta në kompensimin e pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Me datë 1 dhjetor 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-6778 të datës 14 nëntor 2023 (aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit të AL si të pabazuar dhe duke vërtetuar vendimin e AL. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy

afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëj me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Duke injoruar plotësisht parashtruesin e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014 si dhe me nr. GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014.

Me datë 12 gusht 2024, paditësi e kishte pranuar ankesën e palës së paditur mirëpo nuk kishte paraqitur përgjigje.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesat e paditësit për kompensimin e 3 pagave të papaguara në shumën prej 600.00 euro (GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014) si dhe kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 400.00 euro (GJI035-0265 të

datës 1 tetor 2014), ishin refuzuar si të pavlefshme për arsye se sipas vlerësimit të AL-së, këto kërkesa ishin parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova: njoftimin për likuidimin e ndërmarrjes, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 25 nëntor 2005, listën përfundimtare të përfituesve të 20%, një konfirmim të Policisë së Kosovës, një Procesverbal të datës 15 prill 2011 si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Shkalla e parë e DHPGJS-së, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte vërtetuar vendimin e AL-së me nr. GJI035-0266 të datës 3 tetor 2014 sa i përket pjesës së kërkesës për 3 paga të papaguara në shumën prej 600.00 euro, ndërsa vendimin GJI035-0265 të datës 1 tetor 2014 e kishte shfuqizuar, ashtu që e kishte detyruar të paditurën që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj paditësit shumën prej 400.00 euro. Kjo për faktin se sa i përket kërkesës për paga të papaguara ankuesi nuk kishte dorëzuar prova në mbështetje të kërkesës së tij, ndërsa në rastin tjetër për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e kishte provuar të drejtën e tij se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit kompensimin në fjalë.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se ankuesi lidhur me kërkesën e tij për 3 paga të papaguara në shumën prej 600.00 euro nuk kishte dorëzuar asnjë provë në mbështetje të kërkesës së tij, sic mund të ishte ndonjë listë e pagave që dëshmon se sa ka qenë paga e tij mujore, kështu për të vërtetuar pretendimet e tij.

Tutje, sa i përket kërkesës për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës Kolegji i Apelit vëren se nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 25 nëntor 2005, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me 25 nëntor 2005. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime punë për N.SH apo se nuk i takon dëmshpërblimi në fjalë

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 400.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 8 dhjetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_